



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Përmet, më \_\_\_\_\_ . \_\_\_\_\_ 2021

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Për: **Bashkimin e Operatorëve Ekonomik “I.D.K KONSTRUKSION” shpk & “KRONOS KONSTRUKSION” shpk**

Procedura e prokurimit: **E Hapur**

Numri i referencës së procedurës: **REF- 90732-03-23-2021**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Ndërtim i Ujësjellësit Pacomit, Bashkia Përmet”.**

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): s’ka

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “I.D.K KONSTRUKSION” shpk me NIPT K51408016J & “KRONOS KONSTRUKSION” shpk me NIPT K41416033P me vlerë të ofertës: **53 487 207,49** (pesëdhjetë e tre milion e katërqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e shtatë presje dyzet e nëntë) lekë pa TVSH dhe **63 804 648,99** (gjashtëdhjetë e tre milion e tetëqind e katër mijë e gjashtëqind e dyzetë e tetë presje nëntëdhjetë e nëntë) lekë me TVSH.
2. Operatori Ekonomik “MADEKONST” shpk me NIPT L32225018N me vlerë të ofertës: **54 347 667,6** (pesëdhjetë e katër milion e treqind e dyzet e shtatë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë presje gjashtë ) lekë pa TVSH dhe **65 335 742,79** (gjashtëdhjetë e pesë milion e treqind e tridhjetë e pesë mijë e shtatëqind e dyzet e dy presje shtatëdhjetë e nëntë) lekë me TVSH.
3. Operatori Ekonomik “SHTATOR 90 ” shpk me NIPT K51806014S pa vlerë të ofertës.
4. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “TEA-D” shpk me NIPT K32522629L & “AGI KONS” shpk me NIPT K21622001M & “COGREN” shpk me NIPT J74818825K me vlerë të ofertës: **50 490 136** (pesëdhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH dhe **60 478 163** (gjashtëdhjetë milion e katërqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë me TVSH.

Nga verifikimi i dokumentacionit përkatës informojmë **operatorët ekonomik të skualifikuar:**

- **Operatori ekonomik “MADEKONST” shpk**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur për ofertën e tij në sistemin (SPE) për këtë procedurë prokurimi, ky OE nuk ka paraqitur asnjë nga dokumentat e kërkuara për përmbushjen

e kritereve të përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në shtojcën 12 të DST përveç Formularit të Ofertës pa preventivin përkatës e detajuar për çdo zë punimesh.

- **Operatori ekonomik “SHTATOR 90” shpk**

Ky OE nuk ka paraqitur ofertën ekonomike në SPE dhe asnjë nga dokumentat e kërkuara për përmbushjen e kritereve të përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në shtojcën 12 të DST.

- **Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “TEA-D” shpk & “AGI KONS” shpk & “COGREN” shpk**

Nga shqyrtimi në SPE ky BOE ka këto mangësi:

- **Në lidhje me kriteret e përgjithshme** pikën a) Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht; dhe b) Prokura e posaçme BOE ka bërë një kontratë bashkëpunimi ku ka përcaktuar përqindjen e punimeve që do mbuloj secili *por nuk kanë bashkëlidhur një preventiv me zërat e punimeve përkatëse që do të kryej secili nga OE sipas përqindjeve që kanë marr përsipër të mbulojnë.*
- **Në lidhje me pikën 2.2.1** të kapacitetit ekonomik dhe financiar OE “COGREN” shpk nuk ka paraqitur vërtetim për xhiron vjetore të vitit 2018, 2019 dhe 2020 e kërkuar kjo për çdo OE që do jetë anëtar i një BOE.
- **Në lidhje me pikën 2.2.3** OE “AGI KONS” shpk sipas ekstraktit të QKB-së ka ushtruar aktivitetin e tij në vitin 2020 në rrugën “Gjallica”, Lagjja nr. 2 **Bathore Kamëz** objekt në rindërtim shkolla “Halit Coka” dhe në Njësinë Administrative Sukth, Hamallaj, Zona Kadastrale,1925,pasuria,21/22,volum,6, faqe 139 **Durrës**. Nga të dyja këto vende të ushtrimit të veprimtarisë nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2020. OE “COGREN” shpk sipas ekstraktit të QKB-së ka ushtruar veprimtari në në **Fshatin Shales, Bashkia Konispol**, në Zonën Kadastrale: 3316, Numër Pasurie: 358/29 ku ky OE nuk ka dorëzuar vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2020 të lëshuar nga Bashkia Konsipol.
- **Në lidhje me pikën 3.8**
  - Punonjësi Teknik Topograf sipas listpagesës nuk figuron i siguar në muajin shkurt 2021.
  - Për një nga punonjësit Sp.për montim/saldim tubash (minimumi Kategoria II) mungon diplomë/dëshmi/çertifikatëa përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjëgjese shtetërore.
- **Në lidhje me pikën 3.11** çertifikata ISO 1452-1:2009 (Sistemet e tubacioneve plastike për furnizim me ujë, kullimet dhe kanalizimet nëntokësore dhe mbitokësore në presion) ose ekuivalente është dorëzuar nga OE TEA-D shpk. BOE ka bërë një kontratë bashkëpunimi ku ka përcaktuar përqindjen e punimeve që do mbuloj secili *por nuk kanë bashkëlidhur një preventiv me zërat e punimeve përkatëse që do të kryej secili nga OE sipas përqindjeve që kanë marr përsipër të mbulojnë.* Në DST është përcaktuar që çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë përkatësisht Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes dhe ne nuk e dimë se cilat zëra punimesh do mbuloj OE TEA-D shpk pjesë e bashkimit në vlerën 25% të totalit.
- **Në lidhje me pikën 3.12** Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e punimeve objekt kontrate. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik (shtojca 10). Në lidhje me këto mjete janë vërejtur këto mangësi:

*Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 8-15 ton, në pronësi ose me qira, Copë 5 – Janë paraqitur dokumenta vetëm për 3(tre) mjete të tilla që përmbushin këto kapacitete. Pra mungojnë 2(dy) kamion.*

*Aparatura për bashkim tubacionesh me metodën “Elektro FUSION JOINT” PE nga DN 25- DN 315 në pronësi ose me qira, Copë 1- nuk kanë paraqitur foto*

*Damper me kapacitet 0.3 Ton, në pronësi ose me qira, Copë 1- Damperi i paraqitur nga OE AGIKONS shpk është me kapacitet 7 ton ashtu siç deklaron dhe vet OE pra nuk përmbush kapacitetin e kërkuar.*

*Motogenerator / Gjenerator, në pronësi ose me qira, Copë 2 – nuk kanë paraqitur foto*

*Eskavator me goma, në pronësi ose me qira, Copë 2- Kanë paraqitur dokumenta vetëm për një.*

*Eskavator Trencuhr (min 20 Ton), në pronësi ose me qira, Copë 1- Nuk kanë të deklaruar në shtojcat 10 dhe nuk kanë paraqitur asnjë dokument në SPE.*

*Moto pompë thithëse vetëmbushëse, në pronësi ose me qira, Copë 1- Nuk kanë të deklaruar në shtojcat 10 dhe nuk kanë paraqitur asnjë dokument në SPE.*

- **Në lidhje me pikën 3.15** OE TEA-D shpk ka lidhur një kontratë furnizimi me një Prodhues/Distributor për të cilin nuk ka një dokument në gjuhën shqipe që tregon që është i autorizuar. Mallrat objekt furnizimi të kërkuara në DST duhet të jenë të shoqëruara me certifikatën ISO 9001:2015 të prodhuesit të mallit. Një certifikatë ISO 9001:2015 është ngarkuar në SPE në gjuhë të huaj e pa përkthyer e pa noterizuar. Mungon në SPE vetëdeklarimi nga OE ofertues që prodhuesi është konform sistemeve të menaxhimit të cilësisë. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, certifikatën e mësipërme duhet ta paraqesë anëtar i grupit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërit FV referuar preventivit të objektit të prokurimit. BOE ka bërë një kontratë bashkëpunimi ku ka përcaktuar përqindjen e punimeve që do mbuloj secili por nuk kanë bashkëlidhur një preventiv me zërat e punimeve përkatëse në përqindje që do mbulojnë. Pra nuk dihet nëse OE TEA- D që ka lidhur kontratën e furnizimit do të realizoj zërin FV referuar preventivit të objektit të prokurimit.

Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Dokumentacioni administrativ-kualifikues, i paraqitur nga ky BOE nuk është në përputhje me kërkesat ligjore për kualifikim të përcaktuara në shtojcën 12 të DST.

#### **Oferta të kualifikuara:**

#### **Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “I.D.K KONSTRUKSION” shpk & “KRONOS KONSTRUKSION” shpk**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur për ofertën e tij në sistem (SPE) për këtë procedurë prokurimi, rezulton se **Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “I.D.K KONSTRUKSION” shpk & “KRONOS KONSTRUKSION” shpk** plotëson kriteret e kushteve të përgjithshme, kushteve

të veçanta, kërkesat e dokumentacionit të përgjithshëm administrativ, ligjor, teknik dhe ekonomik, sipas kërkesave të AK në njoftimin e kontratës dhe DST të kësaj procedurë prokurimi.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Bashkimin e Operatorëve Ekonomik “I.D.K KONSTRUKSION” shpk & “KRONOS KONSTRUKSION” shpk** me adresë *Autostrada Tiranë-Durrës, Km.12, Rruga Zaja, Koder Bexulle, Nr.Pasurie 1014/3, ZK.1167 Vorë, Tiranë* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **53 487 207,49** (pesëdhjetë e tre milion e katërqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e shtatë presje dyzet e nëntë) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë *Bashkisë Përmet me adresë Sheshi “Abdyl Frashëri” kati i katërt Zyra Juridike*, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës do te veprohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në **datë 07.05.2021**

**Ankesa: JO**

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Alma HOXHA**